## APROVIM TË DEKLARATËS PARAPRAKE

| | |
|---|---|
| *Emri i Shërbimit* | **Kërkesë për aprovim të Deklaratës Paraprake** |
| *Përshkrim i Shkurtër* | Ky shërbim mundëson aplikimin për aprovimin e Deklaratës Paraprake.<br>Në rastet e ndërtimeve, instalimeve dhe punimeve të ndërhyrjeve jothelbësore në objekt kërkohet vetëm deklarimi i punimeve dhe aprovimi (nënshkrimi) nga Bashkia Korçë. Bashkia mund të kundërshtojë deklaratën paraprake për kryerjen e punimeve, me vendim të arsyetuar, në rast se konstaton mosrespektim të kushteve dhe kërkesave ligjore që rregullojnë deklaratën paraprake të punimeve. |
| *Baza ligjore:* | ▪ Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"<br>▪ Ligj nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"<br>▪ Procedura në mbështetje të vendimit të KKT-së nr.1 datë 30.07.2015 "për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore"<br>▪ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" |
| *Përfituesi* | Qytetarët, bizneset |
| *Zyra Përgjegjëse* | Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit |
| *Afati* | 10 ditë |
| *Tarifa* | Sipas dispozitave të përcaktuar në paketën fiskale të Bashkisë Korçë. |
| *Dokumente të nevojshëm* | ✓ Formulari i deklaratës në dy (2) kopje;<br>✓ Dokumenti që vërteton pronësinë e tij apo të drejta të ligjshme për pasuri private apo publike për strukturën që ka në përdorim, në përputhje me legjislacionin në fuqi;<br>✓ Projekti teknik i realizimit të punimeve, i firmosur nga projektues të licencuar.<br>***Dokumentet që duhet të depozitojë personi i interesuar, në letër dhe CD*** |
| *Dokumenti/at e prodhuar si rezultat i shërbimit . (outputs)* | Dokumenti i lejes |
| *Sporteli ku drejtohet qytetari për marrjen e shërbimit* | Sporteli në Bashki<br>Sporteli në Njësinë Administrative |

***<u>Formulari i aplikimi standard që përdoret nga Bashkia.</u>***

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KORÇË**

**Formulari i Deklaratë Paraprake të Punimeve**

**Nr.__________prot/datë**

| X | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | **Projekti (sipas nenit 8 të Rregullores së Zhvillimit)** | Dosja për autoritetin mbikëqyrës | |
| | | Hyrja dhe vula e autoritetit | |
| 2 | **Parcela (Ku ndodhet objekti)** | Rruga, nr. shtëpisë ,komuna, lagja | |
| | | Certifikata e pronësisë ose e drejta ligjore për strukturën në përdorim | |
| | | Planvendosja e objektit<br>Projekti teknik i realizimit të punimeve i firmosur nga një projektues i licencuar | |
| | | Numri dosjes për autoritetin përgjegjës/leja ndërtimi/shkresa sipas [illegible] | |
| 3 | **Objekti** (sipas llojit dhe përdorimit) | | |
| | **Llojet e punimeve** | | |
| 4 | **Fillimi i punimeve** | **Projekti fillon me:** | Dita |
| | | Mbikëqyrja e realizimit të projektit do të kryhet nga ekspeti i autorizuar__________ | |
| 5 | **Zhvilluesi** | Emër mbiemër / firma (përfaqësuesi ligjor ose sekretari ) | Telefon |
| | | Rruga, numri shtëpisë, kodi postal, vendi | Fax |
| | | Me këtë vërtetim, unë tregoj fillimin e punimeve sipas datës të shënuar më sipër.<br>Punimet do të fillojnë______ dita pas dorëzimit të kësaj deklarate. Unë jam i vetëdijshëm se një devijim nga planet e ndërtimit të miratuara dhe nga kërkesat e ligjeve ne fuqi për interesin publik mund të hapin procedura për kundërvajtje kundër meje. | Zhvilluesi |
| 6 | **Drejtuesi teknik** | Emër, mbiemër | Telefon |
| | | Rruga, numri shtëpisë, kodi postal, vendi | Fax |